



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



**Biznesi:** "Java Multimedia Production" SH.P.K.  
**NUI:** 810521387  
**Pronari:** Sara KERMENDI MEHMEDALIU  
**OSHMA:** RROKUM TV  
**Adresa:** Rr/Mbretëresha Teutë, Tasligje Nr.2

**Biznesi:** "Java Multimedia Production" SH.P.K.  
**NUI:** 810521387  
**Kandidatët:** Arben AHMETI dhe Fidan RAMA.  
**Adresa:** Rr/Mbretëresha Teutë, Tasligje Nr.2

### VENDIM


për ndryshimin e pronësisë, respektivisht ndryshimin e pronarit si person fizik, të OSHMA Rrokum TV, ndryshimin e emrit në Kanal 10 si dhe ndryshimin e skemës programore - me seli në Komunën e Prishtinës

### Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Rrokum TV është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA - TV), i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e programeve televizive përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes, me seli në Prishtinë. KPM, me datën 4 dhjetor 2008, ka marr vendim për dhënien e licencës për OSHMA Rrokum TV, për një afat prej dhjetë (10) vitesh, ndërsa më datën 21 dhjetor 2018, KPM ka marrë vendim për ripërtitjen e licencës edhe për një afatë prej dhjetë (10) viteve.
3. OSHMA Rrokum TV ka dorëzuar në zyrën e KPM-së, një kërkesë përmes së cilës ka kërkuar miratim për ndryshimin e pronësisë, respektivisht ndryshimin e pronarit si person fizik dhe bartjen e pronësisë së OSHMA Rrokum TV nga znj. Sara Kelmendi Mehmedaliu tek z. Arben Ahmeti dhe z. Fidan Rama si bashkëpronar, në kuadër të biznesit të njëjtë në të cilin është lëshuar licenca e OSHMA Rrokum TV - "Java Multimedia Production" SH.P.K. me NUI 810521387.
4. Me të njëjtin rastë është kërkuar miratimi i KPM-së edhe për ndryshimin e emrit nga OSHMA Rrokum TV në OSHMA Kanal 10 si dhe ndryshimi i skemës programore.

### Arsyetim

5. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së".
6. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: "Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose



ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”

7. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: “KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”
8. Komisioni konstaton se, kandidatët për pronar të ri të OSHMA Rrokum TV, në mënyrë deklarative me shkrim, kanë shprehur gatishmëri që ofrimin e shërbimeve mediale audiovizuale për publikun, do të bëjnë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe në interes të publikut.
9. Sa i përket qëndrueshmërisë financiare, Komisioni konstaton se, kandidatët për pronar të ri, si pjesë e kërkesës për ndryshime në pronësi të OSHMA Klan Kosova, kanë bashkangjitur edhe dëshmi nga institucionet financiare.
10. Duke u bazuar në gatishmërinë e shprehur të kandidatëve për pronar të ri për të punuar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, dëshmitë rreth qëndrueshmërisë financiare si dhe përvojën profesionale të kandidatëve, Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë së OSHMA Rrokum TV është në interes të publikut.
11. Komisioni konstaton se ndryshimi i emrit të OSHMA Rrokum TV në OSHMA Kanal 10, nuk do të paraqet pengesa apo konfuzion tek qytetarët gjatë përdorimit të tij në transmetimin e programeve televizive dhe si e tillë kërkesa i plotëson kushtet për miratim.
12. Komisioni vlerëson se ndryshimi i skemës programore të OSHMA Rrokum TV, sipas dokumentit të skemës programore të propozuar dhe të bashkangjitur në kërkesë është në interes të publikut.
13. Komisioni vlerëson se, kërkesa është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

### Vendim

14. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur me datën 15 dhjetor 2020, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë, respektivisht ndryshimin e pronarit si person fizik dhe bartjen pronësisë së OSHMA Rrokum TV nga znj. Sara Kelmendi Mehmedaliu tek z. Arben Ahmeti dhe z. Fidan Rama si bashkëpronar, në kuadër të biznesit të njëjt në të cilin është lëshuar licenca e OSHMA Rrokum TV - “Java Multimedia Production” SH.P.K. me Numër Unik Identifikues (NUI) 810521387.
15. Komisioni, merr vendim që të miratoj kërkesën për ndryshim të emrit nga Rrokum TV në **KANAL 10**.
16. Komisioni merr vendim që të miratoj kërkesën për ndryshimin e skemës programore, sipas dokumentit të skemës programore të propozuar dhe të bashkangjitur në kërkesë.
17. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

  
Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



15-12-2020

datë